



Stadi: 01/09/2017

## Aplikim për vizë me qëllim shërbimin vullnetar

Lutemi të lexoni me kujdes këtë fletë-informacioni dhe veproni sipas rregullave të saj. Duke qenë i/e përgatitur mirë ju mund të ndikoni pozitivisht dhe të shkurtoni procedurën përkatëse.

Aplikimet e plotësuar në mënyrë të mangët apo dokumentacioni i paplotë mund të çojnë në refuzimin e aplikimit me pasojë rezervimin e një date të re aplikimi.

Të gjitha dokumentat që tërhiqen pranë Ambasadës (fletët e informacionit, formularët e aplikimit) janë gratis. Të gjitha informacionet rreth procedurës së aplikimit i gjeni në faqen e internetit të Ambasadës: [www.tirana.diplo.de](http://www.tirana.diplo.de)

Në raste të vecanta gjatë aplikimit apo gjatë përpunimit të kërkesës për vizë mund të kërkojnë dokumenta shtesë të papërmendura në këtë fletë-informacioni.

<b>I gjithë dokumentacioni duhet të paraqitet në origjinal!</b>		
1.	<b>Pashaporta e udhëtimit</b> <i>+ 2 kopje (të gjitha faqet e rëndësishme)</i>	Me të paktën dy faqe bosh. Lutemi mbani në konsideratë që afati i vlefshmërisë së pashaportës duhet të jetë tre muaj më i gjatë se kohëzgjatja e vizës. Fotokopjoni ju lutem fletën e plastifikuar me të dhënat personale.
2.	<b>2x formularë aplikimi për vizë kombëtare</b>	Në gjermanisht ose anglisht, të plotësuar në mënyrë plotësisht të lexueshme, të nënshkruara personalisht. Jo aplikime për vizë Schengen!!
3.	<b>3x fotografi</b>	3 fotografi identike biometrike për pashaportë, jo më të vjetra se 6 muaj, me sfond të bardhë, madhësia 45x35 mm. Lutemi që në secilin prej dy formularëve të aplikimit të ngjisni nga një fotografi, ndërsa fotografinë e tretë silleni me vete si element të veçantë.
4.	<b>Tarifa</b>	Gratis
5.	<b>Kontratë ose ofertë konkrete</b> <i>+ 2 kopje</i>	Kontrata për shërbimin vullnetar në origjinal, plus dy kopje, duhet të përmbajë minimalisht të dhënat e mëposhtme:

		<ul style="list-style-type: none"> <li>• Emërtimin e saktë të palëve kontraktuese</li> <li>• Datën e fillimit dhe kohëzgjatjen e kontratës</li> <li>• Informacion rreth llojit të shërbimit vullnetar</li> <li>• Lloji i veprimtarisë së synuar</li> <li>• Vendi i punës dhe vlera e pagës</li> </ul> <p>Kontrata apo marrëveshja duhet të jetë e nënshkruar nga të gjitha palët kontraktuese (organizata përgjegjëse, zyra zbatuese, vullnetari/ja). Nëse në momentin e aplikimit për vizë ekziston vetëm oferta, atëherë kontrata apo marrëveshja duhet të dorëzohen më pas në momentin e tërheqjes së vizës.</p>	
6.	<b>Curriculum Vitae</b> <i>+ 2 kopje</i>	Curriculum Vitae i formuluar nga vetë aplikuesi, duke paraqitur në mënyrë të veçantë kualifikimin dhe eventualisht veprimtarinë profesionale të deritanishme.	
7.	<b>Shkresë motivimi</b> <i>+ 2 kopje</i>	Shkresë motivimi e formuluar nga vetë aplikuesi për shërbimin vullnetar të planifikuar. Ju lutem trajtoni ndër të tjera edhe çështjet e mëposhtme: <ul style="list-style-type: none"> <li>• Pse dëshironi të kryeni këtë shërbim vullnetar?</li> <li>• A keni njohuri të gjuhës gjermane, nëse jo si mendoni t'i përftoni ato?</li> <li>• Çfarë dëshironi të bëni pas kthimit tuja në Shqipëri?</li> <li>• Çfarë prisni se do të jetë dobia e këtij shërbimi?</li> </ul>	
8.	<b>Dëshmi e gjuhës gjermane</b> <i>+ 2 kopje</i>	Dëshmi për njohuri bazë të gjuhës gjermane ose një vërtetim nga ana e organizatës zbatuese, se njohuritë e gjuhës gjermane nuk janë të nevojshme apo se është parashikuar të bëhet një kurs gjuhe.	
9.	<b>Eventualisht dëshmi për një siguracion shëndetësor të mjaftueshëm</b> <i>+ 2 kopje</i>	Kjo dëshmi duhet të paraqitet, vetëm nëse prej kontratës nuk rezulton se është punëdhënësi, ai që e merr përsipër siguracionin shëndetësor.	

#### **Klauzolë e përjashtimit nga përgjegjësia:**

Të gjitha informacionet e mësipërme përcillen pa garancinë se janë të sakta apo të plota. Ato bazohen në stadin informativ të Ambasadës në momentin e hartimit të tyre.